

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	IPAK kërkon shqyrtim të pavarur të gjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së
ADRESA	https://albeu.com/kosove/ipak-kerkon-shqyrtim-te-pavarur-te-gjykimit-ndaj-ish-krereve-te-uck-se/1030456/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:16:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 08:12:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1573f2afdbf1537f968eb145ee0451bad49fc62bad673f6118cd6567d8a80c33
TEKSTI	a9a2fc171c7faa4b67311aa939d5ce7dabb87cd721822f6d52b60147c9fe0294
PAMJA	2c2eb2c52f0220045164232be8f4a7943e45cd33532cbcd6a02cf5afeede7f7e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a871da91690fda61d830ec6138b166f616fef8414e6c40b2d366cfc8447d1682
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a871da91690fda61d830ec6138b166f616fef8414e6c40b2d366cfc8447d1682>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

IPAK kërkon shqyrtim të pavarur të gjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së



IPAK – Instituti për Avansim Kombëtar i ka dërguar një letër institucioneve të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara, si dhe presidentëve të Shteteve të Bashkuara, Francës, Gjermanisë dhe Italisë. Në të kërkohej shqyrtimi i plotë në apel i gjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Nënshkruesit kërkojnë që instanca e apelit të analizojë me kujdes aktgjykimin e shkallës së parë dhe provat kryesore. Ata thonë se, nëse pas shqyrtimit nuk vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm përgjegjësia individuale e të katër të akuzuarve, ligji kërkon lirinë e tyre.

Letra ngre shqetësime për mënyrën se si janë vlerësuar provat dhe dëshmitë e mbrojtjes, besueshmërinë e disa dëshmitarëve, provat shfaqësuese dhe lidhjen mes incidenteve të caktuara e përgjegjësisë individuale. Sipas autorëve, veprimet e individëve në terren nuk përbëjnë vetvetiu provë për përgjegjësi penale të udhëheqësve politikë apo të Shtabit të Përgjithshëm.

Autorët kërkojnë gjithashtu sqarime për raportin e Dick Marty-t të vitit 2011 dhe dallimin mes pretendimeve të tij e akuzave të ngritura më vonë ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit. Institucioneve ndërkombëtare u kërkohej të bëjnë të qartë se cilat pretendime fillestare janë verifikuar dhe si kanë ndikuar ato në themelimin e Dhomave të Specializuara.

Në dokument përmendet edhe mbrojtja që autoritetet zvicerane i kanë ofruar Dick Marty-t. Nënshkruesit vlerësojnë se kjo çështje duhet hetuar më tej, por theksojnë se nuk kanë gjetur prova të mjaftueshme për të pohuar si fakt se raporti i Marty-t ishte sajuar nga Serbia në bashkëpunim me Rusinë.

IPAK kërkon një vlerësim të pavarur e transparent të punës së Dhomave të Specializuara të Kosovës. Ky vlerësim, sipas letrës, duhet të përfshijë shqyrtimin e trajtimit të provave të Prokurorisë dhe mbrojtjes, verifikimin

të fundit /



IPAK kërkon shqyrtim të pavarur të gjykimit ndaj ish-krerëve të...



Latimer: Kosova dhe SHBA-ja, aleate për sigurinë dhe...



Arresti i Vlera Hysenit/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë...



Punësimi i një personi në Maqedoni kushton afro 13 mijë euro në vit



Kuvendi mblidhet sot, Kurti shfaqet në parlament dy orë par...



Projektligji për Byronë i kalon Qeverisë dhe shkon në Kuvend...



Vllaznia ka dy javë kohë për të vendosur kush do ta pasojë Edi...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

e pretendimeve për parregullsi procedurale dhe publikimin e një raporti me pretendimet.

Instituti propozon gjithashtu ngritjen e një Komisioni Mbikëqyrës të Pavarur. Në përbërjen e tij do të përfshiheshin përfaqësues të institucioneve të Kosovës, ekspertë ndërkombëtarë të së drejtës penale, përfaqësues të Këshillit të Evropës dhe të institucioneve të BE-së, si dhe organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Letra kërkon që në trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë të respektohet barazia para drejtësisë. Autorët bëjnë thirrje për hetim dhe ndjekje penale të kujt do për të cilin ka prova të besueshme për krime të kryera gjatë luftës, pa dallim të përkatësisë apo të palës në konflikt.

Në dokument përmenden edhe dëshmitë e zyrtarëve dhe diplomatëve ndërkombëtarë Wesley Clark, James Rubin, Christopher Hill dhe John Duncan për strukturën dhe funksionimin e UÇK-së gjatë luftës. Sipas letrës, këto dëshmi kanë rëndësi për vlerësimin e autoritetit dhe kontrollit faktik mbi strukturat e UÇK-së.

IPAK përsërit se pas shqyrtimit të plotë në apel, katër ish-krerët e UÇK-së duhet të lirohen nëse fajësia e tyre individuale nuk vërtetohet sipas standardit penal "përtej dyshimit të arsyeshëm". Letra nënvizon se aktgjykimi i 16 shtatorit 2026 është i shkallës së parë dhe nuk është përfundimtar.

Në përmbyllje, autorët u bëjnë thirrje institucioneve ndërkombëtare të garantojnë drejtësi të paanshme, transparencë dhe trajtim të barabartë për viktimat dhe të akuzuarit. Ata sqarojnë se nuk kërkojnë privilegj apo imunitet, por përgjegjësi penale individuale, prova të verifikueshme dhe procese të drejta.

Shtuar më 28.09.2026 10:12

Tags: gjykata speciale , procesit , UÇK-se



Latimer: Kosova dhe SHBA-ja, aleate për sigurinë dhe sovranitetin



Kuvendi mbledhet sot, Kurti shfaqet në parlament dy orë para seancës



Projektligji për Byronë i kalon Qeverisë dhe shkon në Kuvend, ekspertët japi...



Ursula von der Leyen viziton Kosovën më 1 tetor



Dosja 23" mund të kthehet në një hap të rëndësishëm kundër...



Pse viktimat e krimeve të luftës mbeten në hije?



Procesi gjyqësor ndaj 21 personave për dëbimin masiv të shqiptarëve nga...



Seancë plenare në Kuvend, në fokus Deklarata për vendimin e Hagës



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.